



ANALIZË

QEVERISJA LOKALE NË RAPORTIN E PROGRESIT



Prishtinë, Republika e Kosovës
Prill 2018

Përmbajtja

Hyrje	3
Temat e adresuara në fushën e qeverisjes lokale	Error! Bookmark not defined.
Zgjedhjet Lokale dhe Përfaqësimi Gjinnor	4
Kapacitetet Njerëzore dhe Financat Lokale	4
Zbatimi i Legjislacionit në Komunitat e Veriut	4
Konfliktet e Interesit tek Zyrtarët Komunalë	4
Rregullativa dhe Procedurat për Ndarjen e Fondeve Publike	4
Planifikimet e Shtëpive Sociale/Mbrojtja dhe Përfshirja Sociale.....	4
Parandalimi i Diskriminimit.....	5
Mbledhja e të hyrave vetanake dhe projektet kapitale.....	5
Shoqëria civile	5
Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe	5
Plani Strategjik i Arsimit dhe Plani i Veprimit	6
Definimi i kompetencave në fushën e inspektimit	6
Sistemi i Menaxhimit të Mbeturinave	6
Raportet/Rekomandimet e Auditorit.....	6

Hyrje

Raporti i Progresit 2018 shërben si pikë reference për institucionet e Bashkimit Evropian lidhur me vlerësimin e progresit të shtetit të Kosovës përgjatë rrugëtimit në BE. Në periudhën raportuese 2017-2018, fusha e qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është analizuar dhe vlerësuar në sektorë të ndryshëm. Vlerësimi i përgjithshëm i Raportit të Progresit është se ka pasur përpjekje për të përmirësuar kapacitetet e qeverisjes lokale.

Krahasuar me Raportin e Progresit të vitit të kaluar, progres është bërë në fushën e qeverisjes lokale, me fokus të veçantë në marrëdhëniet në mes të qeverisjes lokale dhe qendrore, duke përfshirë këtu edhe komunat e veriut. Ky përmirësim i marrëdhënieve, specifikisht në mes të komunave të veriut dhe institucioneve qendrore, ka vazhduar edhe më tej. Po ashtu, progres vlerësohet edhe tek parandalimi i konfliktit të interesit, duke u ulur ndjeshëm numri i rasteve.

Qeverisja lokale për vitin 2017 është karakterizuar me mbajtjen e zgjedhjeve lokale, ku Raporti i Progresit vlerëson konstituimin në afat të Kuvendeve Komunale. Për më tepër, Raporti i Progresit paraqet si sfidë nën përfaqësimin e grave në pozita vendim-marrëse. Edhe pse komunave u është dhënë më tepër fuqi, burimet njerëzore dhe financiare ende mbesin të pamjaftueshme. Raporti i Progresit vendos theksin edhe tek Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, me ç'rast rekomandon përfshirjen e Grantit Specifik për Shërbime Sociale për të siguruar transparencë në buxhet dhe nivel minimum për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Analiza përfshin një përmbledhje të përgjithshme të të gjeturave nga Raporti të Progresit për rezultatet dhe progresin e arritur në fushën e qeverisjes lokale nga viti 2018, njëherësh sfidat dhe kriteret kyçe që duhet adresuar viteve në vijim. Fushat e paraqitura në këtë analizë, njëherësh të vlerësuara nga Raporti i Progresit janë si në vijim: Zgjedhjet Lokale dhe Përfaqësimi Gjinator; Kapacitetet Njerëzore dhe Financat Lokale; Zbatimi i Legjislacionit në Komunitet e Veriut; Konfliktet e Interesit tek Zyrtarët Komunalë; Rregullativa dhe Procedurat për Ndarjen e Fondeve Publike; Planifikimet e Shtëpive Sociale/Mbrojtja dhe Përfshirja Sociale; Parandalimi i Diskriminimit; Mbledhja e të Hyrave Vetanake dhe Projektet Kapitale; Shoqëria Civile; Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe; Plani Strategjik i Arsimit dhe Plani i Veprimtari; Definimi i Kompetencave në Fushën e Inspektimit; Sistemi i Menaxhimit të Mbeturave; dhe Raportet/Rekomandimet e Auditorit.

Instituti KLGJ ka analizuar Raportin e Progresit, me fokus çështjet që lidhen me pushtetin lokal, për më tepër edhe politikën qendrore që shtrihen në komuna. Ky dokument shërben për institucionet, akterët publikë, shoqërinë civile dhe mediat si pikë referuese për sfidat e qeverisjes lokale. Ndërkaq për Institutin KLGJ shërben si instrument në përshtatjen e strategjive dhe fushave të intervenimit në funksion të agjendës së përbashkët drejt reformave evropiane.

Për Institutin KLGJ, nga vlerësimi i parë, fokus i veçantë del forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit mes nivelit qendrore dhe lokal; forcimi i kapaciteteve me theks ato në planifikim të qëndrueshëm; financimi i qëndrueshëm dhe menaxhimi efikas i burimeve; forcimi i bashkëpunimit në mes shoqërisë civile dhe autoriteteve lokale; qartësimi i kompetencave dhe funksioneve; ofrimi i shërbimeve dhe mbrojtjes sociale; dhe adresimi i plotë i rekomandimeve të dala nga auditori.

TEMAT E ADRESUARA NË FUSHËN E QEVERISJES LOKALE

- **Zgjedhjet Lokale dhe Përfaqësimi Gjinator**
 - Raporti i Progresit vlerëson se Kuvendet Komunale pas zgjedhjeve lokale janë konstituar në afatet ligjore;
 - Sa i përket përfaqësimit të grave në pozitat vendim-marrëse, ende ka nën-përfaqësim;
 - Zgjedhjet u cilësuan të jenë konkurruese dhe të administruara mirë;
 - Megjithatë, Raporti vëren se brenda komunitetit serb, fushata është dëmtuar nga kërcënime që për synim kishin favorizimin e Listës Serbe. Janë raportuar raste të dhunës nga komuniteti serb dhe nuk janë marrë përgjigje adekuate nga autoritetet kompetente për zbatimin e Ligjit. Kërkesat e zyrtarëve lartë të Beogradit për votimin e Listës Serbe ngriti shqetësime të thella mbi gjendjen e demokracisë në komunitetin serb të Kosovës.
- **Kapacitetet Njerëzore dhe Financat Lokale**
 - Raporti i Progresit konstaton se edhe pse komunave u është dhënë kompetencë, burimet njerëzore dhe financiare ende mbeten të pamjaftueshme;
 - Referuar Raportit, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal duhet të amendamentohet duke përfshirë në të Grantin Specifik për Shërbime Sociale për të siguruar transparencë në buxhetim dhe nivelin minimal të mbështetjes për shërbime sociale;
 - Një dispozitë që përcakton fonde specifike nga granti i përgjithshëm për shërbime sociale duhet të përfshihet në Projektligjin e ardhshëm për Financat e Pushtetit Lokal
- **Zbatimi i Legjislacionit në Komunitet e Veriut**
 - Sipas Raportit të Progresit, Komunitet e veriut kanë vazhduar përmirësimin e marrëdhënieve të tyre me institucionet qendrore;
 - Katër (4) komunitet e veriut janë pajtuar me legjislacionin për miratimin e buxheteve komunale për vitin 2017;
 - Megjithatë, për shkak të mospërputhjeve të vazhdueshme në shifrat e popullsisë, Raporti i Progresit rekomandon të bëhet regjistrimi në këto katër (4) komunitet.
- **Konfliktet e Interesit tek Zyrtarët Komunalë**
 - Raporti i Progresit gjen se në më shumë se 100 raste, konfliktet e interesit janë penguar ose Agjencia u ka dhënë mendim institucioneve përgjegjëse, shumica prej të cila rasteve janë trajtuar me zyrtarë të qeverisë lokale.
- **Rregullativa dhe Procedurat për Ndarjen e Fondeve Publike**
 - Raporti i Progresit vlerëson se komunitet nuk janë ende të gatshme për përmbushjen e obligimeve të rregullativave të reja.
 - Komunitet kanë kapacitete teknike të limituara për ekzekutimin efektiv të buxhetit në linjë me rregullativat dhe procedurat e reja.
- **Planifikimet e Shtëpive Sociale/Mbrojtja dhe Përfshirja Sociale**
 - Raporti i Progresit paraqet progres të kufizuar nga ana e autoriteteve komunale në miratimin e planeve tre-vjeçare të shtëpive të strehimit social;

- Raporti i Progresit vlerëson se komunat duhet të kenë burime të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve sociale të cilat janë në kompetencë të tyre;
 - Progres i vogël është bërë në përfshirjen sociale të fëmijëve dhe familjeve nga komuniteti Romë dhe Ashkali;
 - Rekomandim i Raportit të Progresit është ofrimi i mundësisë për fëmijë me aftësi të kufizuara për tu edukuar në shkolla publike bashkë me nxënësit e tjerë;
 - Që nga viti 2009, fondet për mirëqenie sociale të ndara përmes grantit të përgjithshëm nuk kanë qenë të specifikuara për këtë kategori (shërbime sociale). Kjo mungesë e qartësisë ka rezultuar në nivele të ndryshme të mbështetjes për ofrimin e shërbimeve sociale;
 - Raporti i Progresit konstaton se edhe pse popullsia e Kosovës që jeton në shkallë ekstreme të varfërisë është në rënie, prapë përqindja mbetet e lartë (17.6 %);
 - Raporti i Progresit nuk sheh progres në livencimin e ofruesve të rinj të kujdestarisë për fëmijët në nevojë;
 - Raporti i Progresit rekomandon që strehimoret për fëmijë të shtrihen në të gjitha komunat e Kosovës;
 - Raporti i Progresit rekomandon që institucionet duhet të rrisin mbështetjen për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucione shkollore.
- **Parandalimi i Diskriminimit**
 - Raporti i Progresit ka vlerësuar se Kosova ka bërë disa përparime në adaptimin e Rregullores për Mekanizmat Institucionalë për Mbrojtje nga Diskriminimi në Qeveri dhe Komuna (definimi i detyrave dhe përgjegjësive të stafit relevant në nivel lokal dhe definimi i koordinimit, raportimit dhe bashkëpunimit me mekanizmat institucionalë për mbrojtje nga diskriminimi;
 - Gratë vazhdojnë të ballafaqohen me sfida në bashkë-pronësi dhe trashëgimi;
 - Raporti e vlerëson si të nevojshëm forcimin e rolit të Agjencisë për Barazi Gjinore dhe rolin e zyrtarëve për barazi gjinore në politikë-bërje në komuna;
 - Integrimi gjinor në Ligje dhe politika ende mbetet i dobët.
- **Mbledhja e të hyrave vetanake dhe projektet kapitale**
 - Bazuar në Raportin e Progresit, sfida në nivelin e lokal mbetet mbledhja e dobët e të hyrave vetanake komunale;
 - Sipas Raportit, mbledhja e dobët e të hyrave vetanake është e lidhur ngushtë me ekzekutimin e projekteve kapitale e cila për pasojë ka vonuar investimet në nivelin lokal.
- **Shoqëria civile**
 - Raporti i Progresit vlerëson progresin ndërmjet nivelit qendror dhe shoqërisë civile, ndërkaq konstaton se përpjekje të mëtejme janë të nevojshme për të siguruar përfshirje dhe bashkëpunim përmbajtësor në nivel lokal.
- **Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe**
 - Raporti tregon se ka pasur ngecje në zbatimin e marrëveshjes së 25 Gushtit 2015;
 - Sipas Raportit, progres është bërë në çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ku me 4 prill 2018, Qeveria e Kosovës i ka dhënë mandat ekipit menaxhues për të filluar hartimin e statutit.

- **Plani Strategjik i Arsimit dhe Plani i Veprimit**
 - Raporti i Progresit rekomandon zbatimin e Strategjisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsim;
 - Sipas Raportit të Progresit, zbatimi i reformës së kurrikulave është dëmtuar nga mungesa e stafit të kualifikuar mësimor dhe nga një sistem i pazhvilluar i vlerësimit të nxënësve;
 - Sfidë tjetër sipas Raportit të Progresit do të jetë profilizimi i mësuesve për klasat 1-5 pa vlerësim të duhur.

- **Definimi i kompetencave në fushën e inspektimit**
 - Raporti i Progresit ngrit si sfidë transferimin e përgjegjësive nga komunat tek Agjencitë për kontrollin e ushqimit, kjo paraqitet si sfidë e vazhdueshme për zbatimin e sistemit të kontrollit të ushqimit.

- **Sistemi i Menaxhimit të Mbeturinave**
 - Raporti i Progresit konstaton se sistemi aktual i menaxhimit të mbeturinave të ngurta në Kosovë është i paqëndrueshëm
 - Strategjia dhe Master Plani 2013-2022 për menaxhimin e mbeturinave janë harmonizuar pjesërisht me planet komunale
 - Raporti rekomandon që autoritetet përgjegjëse të ndërmarrin hapa drejt menaxhimit të mbeturinave (riciklimin e tyre).

- **Raportet/Rekomandimet e Auditorit**
 - Bazuar në Raportin e Progresit, impakti i punës së auditorit është i limituar;
 - Raporti i Progresit rekomandon komunat të implementojnë rekomandimet e auditimit.



Kosovo Local Government Institute
Address: Str. Enver Gjerqeku no. 20, 10000
Prishtinë, Republic of Kosova
Tel: +381 (0) 38 522 000
Mobile: +377 (0) 44 253 835
E-mail: info@klgi-ks.com | Web: www.klgi-ks.com